



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Opština Klokot/Komuna e Kllokot

Datë: 29.04.2021.

Në bazë të nenit 24; nenit : 40.nenit 40.1;40.2 (1) nenit 43. Ligjit për Vetqeverisje Lokale nr. 03/L-040 Ligji mbi financat e qeverisje lokale nr. 03/L-049 nenit 8; si dhe Statutit të Komunës së Kllokotit nenit : 13. Pika 13.3.pika (1).,nenit 18. Kuvendi komunal i Kllokotit në seancën e katërt të rregullt e mbajtur me datën 29.04.2021 bie:

VENDIM
MBI BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE NGA VITI 2020 NË BUXHETIN E KOMUNËS NË VITIN 2021

Neni 1.

Në seancën e katërt të rregullt të Kuvendit komunal e mbajtur me datën : 29.04.2021 u miratua vendimi mbi bartjen e të hyrave nga vetanake nga viti 2020 në buxhetin komunal në vitin 2021. Për vendimin në titull votuan PËR -8; KUNDËR-7; ABSTENIME-0; Në seancë prezent ishin – 15 delegatë në votim individual.

Neni 2.

Mjetet nga të hyrat vetanake nga viti 2020 në vlerë totale prej 96.352.91 €,në buxhetin e komunës në vitin 2021 dhe shpërndahen si më poshtë nga kategoritë ekonomike sipas programeve dhe nënprogrameve:

Mallëra dhe shërbime : Zyra e kryetarit në programin (160) , dhe nënprogrami 16036 të bartet shuma prej :---- 30,241,67 €
Shpenzimet komunale: Zyra e kryetarit në programin (160) , dhe nënprogrami 16036 të bartet shuma prej -----15,000.00 €;
Subvencionet dhe transferet: Zyra e kryetarit në programin (160) , dhe nënprogrami 16036 të bartet shuma prej: -----15,000,00 €
Shenzimet kapitale: të bartet shuma prej-----36,111,24 €;
96,352.91 €

Detaje mbi shpërndarjen e shpenzimeve kapitale nga të hyrat vetanake në buxhetin komunal për vitin 2021:

- Në shpenzimet kapitale mjetet nga të hyrat vetanake nga viti 2020 në vlerë prej 36,111.24€ të bartet shuma në tri projekte.
- Projekti i parë: Barten në buxhetin komunal shuma prej 8,197.34 € në emër të projektit "Mbushja e rrugëve fushore" kodi i të cilit është 48997, dhe i cili është në program (160) dhe nën-program (16036) në zyrën e Kryetarit.
- Projekti i dytë: Barten i shumës prej 7,913.90 € në emër të projektit "Rrethojat në oborrin e shkollës" në buxhetin komunal, kodi i projektit i të cilit është 49896, i cili është në programin 920 dhe nën-programin 94050 i cili shënon vijë në buxhetin komunal arsimit fillor
- Projekti i tretë (I RI) : Bartja e shumës prej 20,000.00 € në emër të "participim në projekte" në program (160) dhe nën-program (16036) në zyrën e Kryetarit.

TOTALI I VLERËS SË BARTJES SË MJETEVE TË BUXHETIT KOMUNAL NGA VITI 2020 NË VITIN 2021 ËSHTË :96,352.91 €

Neni 3.

Qëllimi i miratimit të këtij vendimi të Kuvendit Komunal është që vetëqeverisja lokale të funksionojë normalisht, në mënyrë që përdorë të hyrat e burimeve të veta nga sa u tha më sipër, me qëllim dhe të zgjidhë disa probleme financiare të cilat janë në kompetencë e legjislativit dhe pushtetin ekzekutiv, dhe në interes të qytetarëve.

Neni 4.

Ky vendim i referuar në Nenin 1 do të hyjë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Kuvendit të Komunës së Kllokotit. Vendimi të publikohet në faqen zyrtare të internetit të komunës.

Kopja :

- MAPL
- MEF- Kabinetit kryetarit komunës ;
- Kryesuesit të K.K.Kllokot
- Arkivës së komunës



Kryesuesi i kuvendit komunal Kllokot

Zarko Dejanović /